
PIANISTIC WORKS' PROMOTION LEVEL OF KOSOVAR COMPOSERS SHKALLA E PROMOVIMIT TË VEPRAVE PIANISTIKE TË KOMPOZITORËVE KOSOVARË

INDIRA ÇIPA

Universiteti i Prishtinës, indiracipa@gmail.com

AKTET VI, 3: 290-296, 2013

PERMBLEDHJE

Nisur nga interesi shkencor për trajtimin e shkallës së promovimit të veprave pianistike e për të arritur të konkludimet orjentuese për korrigjimin e shkallës së promovimit të veprave pianistike të kompozitorëve kosovarë, hulumtimi bazohet në supozimin se rrethanat e ndryshueshme socio-historike dhe politike në Kosovë mund të kenë ndikuar në një zhvillim me dinamikë të ndryshueshme të krijimit të veprave pianistike të kompozitorëve kosovarë si edhe në shkallën e promovimit të tyre si në formatin e botuar ashtu edhe në formatin e interpretimit skenik. **Qëllimi i dhe detyrat e hulumtimit:** Pasqyrimi informativ dhe analitik i shkallës së promovimit të veprave pianistike.

Korpusi empirik: 59 vepra pianistike të 17 kompozitorëve kosovarë. **Metoda e hulumtimit:** kuantitative. Përpunimi i të dhënave është bërë me metodën deskriptive statistikore.

Rezultatet: është krijuar pasqyra e argumentuar e shkallës së promovimit të veprave pianistike të kompozitorëve kosovarë.

Fjalët kyç: veprat, pianistike, shkalla, promovimi, kompozitorët

Hyrje

Promovimi është proces që përfshin tërësinë e aktiviteteve që ndërmerren me qëllim të përafrimit të objektit me subjektin, përkatësisht me tërësinë sociale. Kemi të bëjmë me një zinxhir të veprimeve shoqërore ku marrin pjesë shumë subjekte promotore: interpretuesit, botuesit, notografia, pedagogjia pianistike, veprimtaritë mediale, etj. Ky hulumtim ka synuar të përqendrohet dhe të kufizohet në ato parametra, të cilat do të jepnin rezultate të vlefshme dhe të përdorshme brenda për brenda profesioneve të ngushta muzikore: pedagogji-metodikë e pianos, kompozim, interpretim.

Estetika e muzikës, ekzistencën e një veprave muzikore e trajton përmes dy aspekteve të përgjithshme: 1.aspekti i idealitetit dhe 2.aspekti i objektivitetit. Ndërkaq forma të ekzistimit të veprës muzikore i konsideron formatet: 1. idea kompozicionale, 2. vepra e shkruar-partitura, 3. idea interpretuese, 4. interpretimi, 5. incizimi.

Interesi social në raport me veprat muzikore ka bërë që njerëzimi gjatë evoluimit të vet kulturor dhe intelektual idealitetin e veprës muzikore të arrijë ta shndërron në tri formate objektive që mundësojnë objektivizimin dhe transicionin e saj në drejtime të ndryshme. Kjo, me gjuhën bashkëkohore nominohet si promovim, gjë e cila realizohet përmes formateve: 1. vepra e shkruar - partitura, 2. interpretimi, 3. incizimi.

Vështrimi i bërë aspektit të rrethanave sociale të periudhës kohore të krijimit të veprave pianistike të kompozitorëve kosovarë të përfshira në hulumtim, rezultoi të jetë një periudhë e karakterizuar me ndryshime të mëdha sociale, politike dhe kulturore e përshkruar me zhvillime dhe ngecje. Ky vështrim diferencoi tri faza thellësisht të ndryshme mes vete: Faza I: 1944-1990 – fazë fillestare dhe e zhvillimit, Faza II: 1990-1999 – fazë e suprimimit të funksionimit të institucioneve kulturore-artistike, Faza III: nga 1999 – fazë e konsolidimit të zhvillimit të pavarur

kulturor. Kualifikimet përkatëse të fazave të zhvillimeve sociale në mënyrë të drejtpërdrejtë imponuan nevojën që korpusin e kompozitorëve ta kategorizojmë në 3 gjenerata, me supozimin se rrethanat sociale kanë ndikim të fuqishëm si në aktivitetet promocionale të veprave artistike ashtu edhe në vet krijimtarinë e kompozitorëve kosovarë. Ky supozim edhe shërbeu si fokus i kërkimit të përgjigjeve gjatë hulumtimit. Mbi këtë bazë janë formuar 3 kategori kompozitorësh:

1)Gjenerata I-Kompozitorët e lindur ndërmjet 1935 dhe 1950, 2)Gjenerata II-Kompozitorët e lindur ndërmjet 1950 dhe 1970 dhe 3)Gjenerata III-Kompozitorët e lindur ndërmjet 1970-1990.

Faza përgaditore e hulumtimit ka treguar se lufta në Kosovë (1998-1999) ka zhdukur shumë incizime si edhe teknikën kompatible për dëgjimin e incizimeve të ruajtura në arkivin e RTK-së si trashëgimi e bartur nga produksioni i RTP-së, si edhe një numër të caktuar të partiturave në dorëshkrim. Kështu që trajtimi i incizimeve të veprave pianistike të kompozitorëve kosovarë, nuk ka mundur të jetë objekt studimi.

Metoda e përdorur në hulumtim:

Është përdorur metoda kuantitative e hulumtimit, përpunimi i të dhënave është bërë me metodën deskriptive statistikore dhe rezultatat janë paraqitur me tabela dhe grafikone

Qëllimi i hulumtimit:

Një nga qëllimet e hulumtimit ishte formimi i bazës së të dhënave lidhur me shkallën e promovimit të veprave pianistike të kompozitorëve kosovarë dhe argumentimi themelor kuantitativ, i vlefshëm për kualifikimet eventuale të interakcionit shoqëri-vepër pianistike.

Detyrat e hulumtimit janë të natyrës Informative dhe analitike.

Korpusin empirik e përbëjnë 59 vepra pianistike të 17 kompozitorëve Kosovarë.

Objekt i hulumtimit janë: Formati i shkruar dhe ai i interpretuar i veprave pianistike të kompozitorëve kosovarë.

Grumbullimi i mostrave ka përfunduar në qershor të vitit 2010.

DISTRIBUIMI DHE REZULTATET

Të dhënat themelore të cilat do të trajtohen në vazhdim (mostrat e hulumtuara, sasia e tyre, kompozitori dhe numri rendor i kompozitorit), janë:

1.Mark Kaçinari (4 vepra), 2. Vinçenc Gjini (2v.), 3. Esat Rizvanolli (3v.), 4. Akil Koci (1v.), 5. Fahri Beqiri (5v.), 6. Zeqirja Ballata (10v.), 7. Rauf Dhomi (10v.), 8. Rafet Rudi (6v.), 9.Gjon Gjevelekaj (3v.), 10. Bashkim Shehu (1v.), 11. Mendi Menxhiqi (5v.), 12. Valton Beqiri (1v.), 13. Trimor Dhomi (3v.), 14. Kreshnik Aliçkaj (1v.), 15. Dafina Zeqiri (2v.), 16. Kushtrim Gashi (1v.), 17. Drinor Zymberi (2v.).

Radhitja e kompozitorëve është bërë sipas ditëlindjes së tyre (nga më e e hershmja deri te me e vona).

Formati i shkruar i veprave pianistike të kompozitorëve Kosovarë

Argumentimi lidhur me formatin e shkruar të veprave pianistike të përfshira në hulumtim është kërkuar në numeracionet (kodet botuese), përkatësisht ISBN-të, që paraqesin gjasën elementare për përhapjen-përkatësisht promovimin e një veprë muzikore në njërën anë. Ndërsa në anën tjetër, përmes frekuencave të gjetura të formatit të dorëshkrimit, që paraqet argumentin themelor për ekzistimin e veprës, e që në aspektin e promovimit në kuptimin bashkëkohor paraqet një gjendje latente të veprës në raport me procesin kompleks të promovimit, pasqyrohet shkalla e promovimit të veprave pianistike të kompozitorëve kosovarë.

Të dhënat lidhur me formatin e shkruar të veprave pianistike, përkatësisht lidhur me botimin e tyre, rezultuan me 6 kategori: veprat e botuara nga botues vendës që kanë numër të përbashkët të ISBN-së, veprat e botuara nga botues të huaj që kanë numër të përbashkët të ISBN-së. (është fjala për kategoritë që përfshijnë veprat e botuara në përmbledhje veprash nga më shumë autorë). Dy kategoritë vijuese përfshijnë veprat që bartin numër individual të ISBN-së me


botues vendor dhe kategoria e kërkuar-ajo me numër të ISBN-së me botues të huaj. Në hulumtim janë gjetur edhe vepra, të botuara në vitet 70-të, të cilat nuk kanë kurrëfarë numri administrativ-botues. Veprat e këtilla janë klasifikuar në një kategori të veçantë. Kategorinë e gjashtë e përbëjnë veprat e pabotuara, numri i të cilave është i konsiderueshëm, artefakte këto të cilat në hulumtim janë shqyrtuar në formatin e dorëshkrimit. Për nevoja praktike të përpunimit të të dhënave, kategorive të lartpërmendura u është bërë indeksimi me shkurtesa, tabela e të cilave paraqitet në vijim:

INDEKS	frekuenca
ISBN-PV (e përbashkët vendore)	25
ISBN-PH (e përbashkët e huaj)	1
ISBN-IV (individuale vendore)	2
ISBN-IH (individuale e huaj)	0
BVPN (botim vendor i panumerizuar)	3
Dorëshkrime	28
GJITHSEJ	59

Tab. 1. Indeksimi i kategorive të formatit të shkruar dhe frekuencat

Me frekuencë më të lartë paraqitet kategoria e dorëshkrimeve (28 frekuenca), ndërkaq nuk shenohet asnjë frekuencë në kategorinë e kërkuar ISBN individual i botimit të huaj (ISBN-IH). Kategoria ISBN e përbashkët vendore shenon një frekuencë të lartë prej 25 frekuencash, gjë që është realizuar me botimin e albumit me 23 vepra pianistike të kompozitorëve Kosovarë nga ana e AShAK (Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, 2009) me redaktimin e Engjell Berishës.


Pie Chart-i vijues pasqyron përqindjen e kategorive të formatit të shkruar.



Graf.1. Kategoritë e formatit të shkruar në përqindje


Kronologjia e botimit dhe e krijimit të veprave pianistike

Të dhënat në bazën vijuese të të dhënave janë futur me renditje kronologjike (time range) me intervale kohore prej një viti, që ka krijuar një renditje prej 50 intervalesh kohore duke filluar nga viti 1961-2010. Me kryqëzimin e frekuencave të krijimit dhe të botimit të mostrave është kërkuar përgjigje për raportin social ndaj publikimit të krijimtarisë pianistike. Lëvizja e lakoreve tregon se nuk ka një përputhshmëri kohore të dëshirueshme mes tyre. Në fazën e parë vërejmë të ketë tendenca të përafërimit të tyre, megjithqë krijimi shenon frekuenca më të larta se botimet. Faza e dytë shenon një rënie në krijime ndërsa botimet nuk ekzistojnë fare (0). Në fazën e tretë veçohet viti 2009 që shenon kulminacionin e lëvizjes së lakores duke arritur frekuencën prej 23 njësisish, gjë që arrihet me botimin e Albumit të veprave pianistike të kompozitorëve Kosovarë.



Graf.1. Kronologjia e krijimit dhe e botimit të veprave

Në vijim janë paraqitur rezultatet e distribuimit në raport me formatet e partiturave. Janë gjetur 31 vepra të botuara dhe 28 dorëshkrime. Përqindja grafike e këtij raporti pasqyrohet me Pie chartin vijues:




Graf. 2. Raporti i kategorive të veprave të shkruara

Distribuimi i rezultateve të kategorive të formatit të shkruar në raport me gjeneratat e kompozitorëve

Kategoria	Botimet	Dorëshkrimet
Gjenerata I	26	14
Gjenerata II	4	6
Gjenerata III	1	8

Tab. 2. Gjeneratat e kompozitorëve në raport me kategoritë e formatit të shkruar

Pie Chart-i shpreh se gjenerata e parë veçohet me përqindjen e lartë të botimeve (83.3%) nga numri i përgjithshëm i veprave të botuara. Me një distancë të madhe dhe me përqindje dukshëm më të ulët, me 13.3%, pason gjenerata II. Ndërkaq gjenerata e tretë shenon vetëm 3.3%.



Graf. 4. Gjeneratat e kompozitorëve në raport me kategoritë e formatit të shkruar në përqindje

Pjesëmarrja e dy formateve në numrin e përgjithshëm të korpusit empirik gjithsesi jep përqindje të tjera. Edhe në këtë mënyrë të përpunimit të rezultateve prin gjenerata I me 42.37%, pason gjenerata II me 6.77%, ndërkaq gjenerata III shenon 1.16%. Diferenca mes tyre zvogëlohet kur bëhet fjalë për dorëshkrimet. Kështu gjenerata I shenon një përqindje më të lartë duke arritur 25.42%, gjenerata e II me përqindjen e arritur prej 10.16% zhvendoset nga pozicioni i dytë në pozicionin e tretë, sepse gjenerata III me përqindjen prej 13.56% të veprave në dorëshkrim vendoset në pozicionin e dytë.

Botuesit

Në zinxhirin promovues, botuesit paraqesin një hallkë me fuqi dhe interes kompleks dhe kanë një rol të veçantë dhe determinues në procesin e promovimit të veprave muzikore, përkatësisht pianistike.

Nga të dhënat për botuesit janë gjetur pesë kategori. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës (AShAK), Lidhja e Shoqërive Muzikore të Kosovës (LShMK), Shoqata e Kompozitorëve të Sllovenisë (DSS-Društvo Slovenskih Skladateljev), NOTA-Knjazhevac dhe PERMUSIC (Gjermani).

Botuesi	frekuenca e veprave të botuara	%	Interpretimi skenik i veprave
AShAK	23	74.19	Kërkimet lidhur me interpretimin skenik të veprave pianistike të kompozitorëve Kosovarë, rezultoi me tri kategori: të interpretuara, të painterpretuara dhe të panjohura. Në kategorinë e ndominuar me E PANJOHUR janë kategorizuar veprat lidhur me interpretimin e të cilave kanë
LShMK	3	9.6	munguar burimet e informatave për arsyt vijuese: kompozitori ka ndëruar jetë, nuk ekziston ndonjë institucion i cili merret me arkivimin e këtyre të dhënave, kompozitori është në jetë, por mungojnë mundësitë për t'u kontaktuar, autori nuk mban evidencë lidhur me interpretimin skenik të veprave. Në qelizën „kompozitori“, të dhënat janë futur sipas numrit rendor që mban kompozitori (fq.2). Ndërkaq, në qelizat e kategorive të dhënat, janë futur në bazë të numrit të përgjithshëm të korpusit të veprave të kompozitorit përkatës, përkatësisht të çdo antari të korpusit empirik.
DSS	2	6.66	
NOTA	2	6.66	
PERMUSIC	1	3.22	

Tab. 3. Botuesit dhe frekuenca e botimeve

Përqindja e sipërme e pjesëmarrjes së botuesve është llogaritur në raport me numrin 31, sa është edhe numri i përgjithshëm i veprave të botuara, sikur që është paraqitur në nënkapitullin paraprak. Me 74.19% prin ASHAK, pason LSHMK me 9.6%, me 6.66% përfaqësohen DSS dhe NOTA, ndërkaq me 3.22% radhitet PEERMUSIC.

Nr. Rend. i kompoz.	Vepra të interpretuara	Vepra të painterpretuara	E panjohur
1	4	0	0
2	0	0	1
3	0	0	3
4	1	0	0
5	5	0	0
6	5	5	0
7	9	1	0
8	5	2	0
9	0	0	3
10	0	0	1
11	1	4	0
12	0	1	0
13	3	0	0
14	1	0	0
15	2	0	0
16	1	0	0
17	0	2	0


Tab. 4. Interpretimi i veprave në skenën vendëse

Nr.i kompoz	Vepra të interpr.	Vepra të painterpretuara	E panjohur
1	1	3	0
2	0	0	1
3	0	0	3
4	1	0	0
5	4	1	0
6	6	4	0
7	2	8	0
8	4	3	0
9	0	0	3

Tab.5. Interpretimi i veprave pianistike në skena të huaja

Nga rezultatet e përgjithshme të fituara, renditja është bërë për tri vlerat më të larta të shenuara. Vlerën më të lartë prej 9 frekuencash, e shenojnë veprat e Rauf Dhomit, vlerën e dytë me radhë me nga 5 frekuenca, e arrijnë veprat e Zeqirja Ballatës, Fahri Beqirit dhe Rafet Rudit. Ndërsa në pozitën e tretë me 4 frekuenca, ndodhen veprat e Mark Kaçinarit

Nga rezultatet e fituara janë renditur tri vlerat më të larta. Vlerën më të lartë, prej 6 frekuencash e shenojnë veprat e Zeqirja Ballatës. Vlerën e dytë me radhë prej 4 frekuencash e arrijnë veprat e Fahri Beqirit dhe Rafet Rudit, ndërsa në pozitën e katërt me 3 frekuenca radhitet Trimor Dhomi.



Graf. 5. Rezultatet e shkallës së interpretimit të veprave pianistike në skenat vendore dhe të huaja

Konkluzion

- Dinamika e krijimit, e botimit dhe e interpretimit skenik të veprave pianistike të autorëve kosovarë reflekton ndikimet dhe relacionet socio-kulturore dhe politike.

- Zinxhiri promovues i veprave pianistike si: pedagogjia pianistike, pianistët, festivalet mediati, botuesit, bibliotekat, politik-ligjvënësit kulturor mund të shërbehen me këto argumente të kuantifikuara me rastin e hartimit të programeve dhe politikave të tyre.

- Konsideroj se në këtë zinxhir promovues duhet të prijnë vet kompozitorët.

- Janë fituar rezultate të kuantifikuara të vlefshme për të shërbyer për hulumtime të mëtejme, për krahasime, kualifikime, për përmirësimin e promovimit, administrimit, dhe të përdorimit të veprave pianistike të kompozitorëve kosovarë.

- Rezultatet mund të shërbejnë si bazë e të dhënave për ndonjë studim që ka për interes ta hulumtojë interaksionin e përbërësve të zinxhirit promovues profesional: kompozitor, mësimdhënës i pianos, pianist.

BIBLIOGRAFIA:

Ballata, Zeqirja. 1987. *Gjurmëve të muzës*. Prishtinë: Rilindja
 Berisha, Engjëll. 1997. *Zhvillimi i stileve në veprat e kompozitorëve shqiptarë të Kosovës*. Prishtinë: Enti për botimin e teksteve dhe mjeteve mësimore i Kosovës

- Buzharovski, Dimitrije. 1996. *Увод во анализата на музичкото дело*. Shkup: FMU
- Buzharovski, Dimitrije. 2002. *Основи на дигиталното архивирање*. S: ИРАМ
- Џипа, Lefter. 2007. *Flet princi i polifonisë*. Tirana: UEGEN
- Colvell, Richard.ed. 2006. *Handbook of Research Methodologies*. Oxford university press
- Dibelijus, Urlih. 1997. *Komponovanje uprkos dogmatskom pritisku, estetski koncepti posle 1945. i danas*. Novi zvuk nr 8
- Foght, Ivan.1980. *Savremena estetika muzike*. Beograd: Nolit
- Hartman, Nikolaj. 1979. *Estetika*. Beograd: BIGZ
- Hysi, Fatmir. 2005. *Estetikë në tri pamje*. Tiranë: UEGEN
- Kuk, Derik. 1959. *The language of music*. London: Oxfford Unevrsity Press
- Markuze, Herbert. 1977. *Kultura i društvo*. Beograd: Beogradski izdavačko-grafički zavod
- Michel, Donald. 1983. *The language of modern music*. Beograd: Nolit
- Mitevaska, Irena. 2005. *Проблеми на дигитализацијата на мелограми (магистарски труд)*. Shkup: FMU
- Rudi, Rafet. 2002. *Sprova estetike/muzika e shekullit XX*. Pejë: Dukagjini
- Shupo, Sokol. 2005. *Biographical dictionary of Balkan composers*.Tirana: ASMUS
- Sokoli, Ramadan. 1994. *16 shekuj*. Tiranë: Eurorilindja
- Zoriq, Ivica. 2007. *Дигитален каталог за македонското хорско творештво*,(disertacion doktoral). Shkup::FMU
- Zhuniq, Dragan.1995. *Sociologija umetnosti*. Nish: Fakulteti filozofik
- Zhuniq, Dragan.1994. *Svakidašnji ukus, kritika moći sviđanja*. Nish: Prosveta.